

VENDIM
Nr.43, datë 31.1.2007

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.230, DATË 4.4.1998 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PRIVATIZIMIN E PJESËVE TË KAPITALIT TË ZOTËRUAR NGA
SHTETI NË SHOQËRITË ME KAPITAL TË PËRBASHKËT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 23 të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Paragrafi i dytë i pikës 8 të vendimit nr.230, datë 4.4.1998 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Periudha e publikimit zgjat 21 ditë nga data e publikimit të parë dhe bëhet në çdo botim të Buletinit të Njoftimeve Publike, brenda këtij afati. Data e parë e publikimit është data e përcaktuar në njoftimin që Ministria e Financave (Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike), dërgon për publikim. Krahas këtij, publikimi bëhet edhe nëpërmjet internetit (faqja e Ministrisë së Financave).”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha